

“ADI GAZ 2020” Sh.A

STATUT

I SHOQERISE AKSIONERE

“ADI GAZ 2020” Sh.A

Ne qytetin e Durrësit, sot me datën 20 SHKURT, 2020, në Mbledhjen e parë të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqërisë me aksionerin e vetëm themelues të Shoqërisë:

Z. Adrian Mujali, i datëlindjes 14.05.1972, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Durrës, Shqipëri, me letërnjoftimin nr 029412571 e vlefshme deri në 29.07.2020 dhe bazuar në:

- * Vullnetin tone të lire, të plote, të sinqerte, të perbashket dhe në inisiativën e lire private,
- * Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,
- * Në Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Per tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,
- * Në Ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”
- * Në Ligjin Nr.7764 datë 02.11.1993 “Per Investimet e huaja”
- * Në Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 “Per PERPUNIMIN, Transportin dhe Tregetimin e NAFTES, GAZIT e të nenprodukteve të tyre.”

* Në Vendimin e Këshillit të MINISTRAVE Nr.129 datë 18.03.1999.

* Në Kodin Doganor, Legjislacionin Tatimor, Fiskal, Bankar, të Drejtën tregtare ndërkombëtare Private dhe Konventat ndërkombëtare të gjithëpranuara të Komunitetit Europian, miratojmë me unanimitet të plote me 100% të votave “Pro” miratojmë STATUTIN e ri Shoqërisë Aksionere “ADI GAZ 2020” Sh.a

Neni 1

Shoqëria AKSIONERE me Aksioner të vetëm shtetasin Z Adrian Mujali e ka emërtimin e vet “ADI GAZ 2020” Sh.A. emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj dhe me të cilin do të paraqitet në çdo dokumentacion dhe në marrëdhëniet me të tretet.

Në të gjitha aktet dhe dokumentat që do të nxjerr Shoqëria, ky emërtim i saj do të shoqërohet duke u shënuar në të dhe shuma e Kapitalit Themeltar si dhe Selia Qendrore.

Neni 2

Aktivitetin e saj Shoqëria Aksionere “ADI GAZ 2020” Sh.a e shtrin në të gjithë juridiksionin territorial të shtetit shqiptar si dhe jashtë shtetit.

Neni 3

SELIA Qendrore e Shoqërisë është në adresën:

Lagja nr. 14, Rruga Tirana, Objekt me nr. pasurie 1/230, Zona Kadastrale 8516
Durrës – ALBANIA

Me Vendim të Këshillit të ADMINISTRIMIT, mund të çelen, transferohen ose mbyllen (në rast se janë çelur) DEGE e FILIALE si brënda vendit dhe jashtë shtetit, me kusht që ky VENDIM të miratohet nga Mbledhja me e afert e Asamblesë së Aksionereve.

Neni 4

Shoqëria AKSIONERE “ADI GAZ 2020” Sh.a është Person Juridik Shqiptar.

N e n i 5

Personalitetin JURIDIK ,Shoqeria e fiton nga data e aplikimit dhe miratimit te akteve te themelimit prane QKR ,ndersa ushtrimin e veprimtarise Tregtare te saj e fillon menjehere pas marrjes se Certifikates NIPT(NIUS) prane QKR si dhe te

N e n i 6

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise "Aksionere" eshte **PA AFAT** ,duke filluar ky afat nga data e regjistrimit ne QKR .

Ky **AFAT** mund te zgjatet ose ndryshoj me **VENDIM** te Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise mbi bazen e **VENDIMIT me ¾ e votave** te shumices se Aksionereve sipas rregullave te parashikuara ne ligj.

Kohezgjatja e Shoqerise AKSIONERE mbaron dhe para ketij AFATI , ne rastet e prishjes se Shoqerise ,kur ekziston nje nga kushtet ligjore te parashikuara nga neni 187 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare."

N e n i 7

Kapitali Themeltar i Shoqerise AKSIONERE " **ADI GAZ 2020** " Sh.A. dhe me **Oferte Private** (jo Publike) caktohet dhe perbehet nga kapital ne likuditet ne shumen : 3,500,000 LEKE i formuar dhe nenshkruar nga AKSIONERE I VETEM: Z. Adrian Mujali

Vlera nominale e nje aksioni caktohet 1000 lek dhe numri i pergjithshem i aksioneve eshte **3,500 aksione** , ku 1 aksion/1000 lek ,ka vleren juridike te 1 vote me te drejte vendimore.

Kapitali Themeltare zoterohet ne masen 100% nga aksioneri i vetem themelues Z. Adrian Mujali. Kapitali themeltare eshte paguar ne masen 28.5 % (ose 1,000,000 lek) nga aksioneri i vetem Z. Adrian Mujali, te vlere 3,500,000 leke kontribut ne para.

N e n i 8

Mbledhja e ASAMBLESE se Aksionereve zoterues te AKSIONEVE merr vendim per rritjen dhe zvogelimin e KAPITALIT ,ne baze te se drejtes qe parashikohet nga **neni 135 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008** "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe kur ky **VENDIM** miratohet me ¾ e votave te aksionereve te Shoqerise,zoterues te kapitalit themeltar,te pranishem ne mbledhje ose te perfaqesuar me Prokure te bere me akt noterial,te cilet gezojne te drejten e votes vendimore.

N e n i 9


Shoqeria Aksionere "**ADI GAZ 2020**" Sh.a ka OBJEKT zhvillimin e veprimtarise tregtare ne keto drejtime kryesore :

Tregtimi me shumice si dhe shperndarja e naftes,benzines, gazit dhe nenprodukteve e derivateve te tyre. Ndertimi, marrja me qera e fabrikave, instalimeve, rafinerive, magazinave, depozitave etj. Transportin e naftes, benzines, gazit dhe neprodukeve e derivateve te tyre me te gjitha mjetet e transportit detar, tokesor te gjitha kapaciteteve si dhe tregtimin e makinerive, pajisjeve dhe njohurive ne kete fushe, etj.Tregtimi, mbushja dhe trasporti i bombulave me permasa te ndryshme te mbushura me gaz te lengezuar te naftes. Tregti me shumice dhe pakice te gazit.. Hotel. Transport Karburantesh per te trete. Marrja me qera e pikave te karburanteve dhe stacioneve te tregtimit me shumice dhe pakice te naftes benzines dhe gazit. Tregtimi, transporti dhe mirembajtja e paisjeve dhe makinerive te impjanteve elektrike, mekanike dhe elektronike te aperaturave dhe pajisjeve te tregtimit te hidrokarbureve ne stacionet e tregtimit me pakice dhe shumice te hidrokarbureve. Riparimi i te gjitha modeleve te autoboteve dhe cisternave te tregtimit dhe transportit te naftes gazit dhe benzines.

N e n i 10

Organet Drejtuesë te Shoqerise Aksionere jane :

1.ASAMBLEJA E PERGJITHSHME



3. ADMINISTRATORI

Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise perbehet nga tersia e numrit te aksionereve themelues te Shoqerise si dhe e cdo personi tjeter, person juridik apo fizik, vendas apo i huaj, qe fiton statusin ligjor te aksionerit te Shoqerise mbi bazen e blerjes se aksioneve dhe eshte organi me i larte drejtues dhe vendimarrës i Shoqerise.

Keshilli ADMINISTRIMIT eshte organ KOLEGJIAL qe perbehet nga tersia e jo me pak se 3 personave, te cilet mund te jene aksionere ose individe jashte Shoqerise qe ushtron te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe parashikohen nga neni 154 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerise tregtare, si dhe Vendimet e Asamblese Pergjithshme.

Ne mbledhjen e pare themeluese Asambleja e Shoqerise, me pjesmarrjen e te aksionerit te vetem themelues dhe me votim unanim dhe 100% te votave "Pro" vendosi qe Keshilli ADMINISTRIMIT te perbehet nga 3 veta dhe konkretisht nga keta persona:

- | | |
|-----------------------|--|
| 1. Z. Adrian Mujali | i datelindjes 14.05.1972, banues ne Durres |
| 2. Z. Griseldi Mujali | i datelindjes 28.04.1999, banues ne Durres |
| 3. Z. Eduart Kani | i datelindjes 09.09.1984, banues ne Durres |

Anetaret e Keshillit Administrimit , zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per nje afat kohor 3 vjet, duke filluar ky afat nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR deri me daten 19.02.2023, me te drejte rizgjedhje.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoj ne cdo kohe , nje anetar te Keshillit ADMINISTRIMIT, me shumice te thjeshte votash duke marr vendim me shkrim, ose mund te pranoj DOREHEQJEN e paraqitur nga anetari i Keshillit Administrimit po mbi bazen e vendimit me shkrim dhe te emeroj nje anetar te ri te Keshillit Administrimit per te plotesuar vendin vakant te lene nga anetar i Keshillit Administrimit qe eshte larguar me vendim nga Asambleja e Pergjithshme ose mbi bazen e pranimi te doreheqjes.

ADMINISTRATORI i Shoqerise eshte personi i emeluar nga KESHILI ADMINISTRIMIT qe ngarkohet per te kryer te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te Shoqerise brenda kompetencave te Ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe STATUTIN e Shoqerise, zbaton Vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe te Keshillit Administrimit dhe eshte perfaqesuesi ligjor i Shoqerise ne mardheniet e Shoqerise me te tretet.

Si rregull dhe pergjithesisht ADMINISTRATORI i Shoqerise, bazuar ne nenin 158 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 emerohet dhe shkarkohet ne cdo kohe me shumice te zakonshme votash te Keshillit te Administrimit

Emerohet administrator i shoqerise

Z. Adrian Mujali , i datelindjes 14.05.1972 , banues ne Durres. Emerimi i tij behet per nje periudhe kohe 3 vjet, duke filluar ky afat nga data e regjistrimit te Shoqerise ne QKR deri me daten 19.02.2023 , me te drejte rizgjedhje.

KESHILI I ADMINISTRIMIT , emeron dhe shkarkon ne cdo kohe , ADMINISTRATORET e Shoqerise me shumice te thjeshte votash duke marr vendim me shkrim, ose mund te pranoj DOREHEQJEN e paraqitur nga administratori po mbi bazen e vendimit me shkrim dhe te emroj ADMINISTRATORIN e ri menjhere sapo largon ADMINISTRATORIN e meparshem te shkarkuar nga Keshilli ADMINISTRIMIT apo me doreheqje te tij dhe , emerimi i Administratorit te ri, behet po mbi bazen e nje VENDIMI tjeter nominativ me shkrim dhe tagrat e Administatorit te ri fillojne nga data e regjistrimit te vendimit te emerimit te ri ne QKR.

Neni 11

ASAMBLEJA e SHOQERISE

Me Asamble si nocion juridik, kuptohet tersia numerike e anetaresise te individeve, personave fizik apo juridik, vendas apo te huaj , te cilet jane ose behen ne te ardhmen aksionere te Shoqerise mbi bazen e kontributit ne formimin dhe nenshkrimin e kapitalit themeltar dhe qe gezojne aksione, sipas vleres nominale te percaktuar ne kete Statut dhe te drejten e votes vendimore .

a. ASAMBLEJA PERGJITHSHME ka keto te drejta dhe detyrime:

1. Merr vendime per percaktimin e politikave tregtare.
2. Emeron dhe shkarkon , anetaret e Keshillit administrimit e shoqerise.
3. Emeron dhe shkarkon Ekspertin Kontabel te autorizuar dhe te Likuidatorit.
4. Miraton skemen e shperblimeve te Ekspertit Kontabel te autorizuar dhe te Likuidatorit.
5. Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise tregtare.

6.Vendos per pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre,miraton me vendimmarrje ndreyshime ne te drejtat qe lidhen me aksione te llojeve te kategorive te vecanta.

7.Vendos per perfaqesimin e Shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit.

Keto vendime nga Asambleja e Zakonshme ,sikurse parashikohet nga neni 114/1 i Ligjit.Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ,merren me shumicen e zakonshme,qe perbehet nga aksioneret qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve me te drejte vote vendimore te pranishem ose me perfaqesim ne mbledhjen e Asamblese.

1.Vendos per ndryshimet ne STATUT.

2.Vendos per shperndarjen e fitimeve vjetore.

3.Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te rregjistruar.

4.Merr vendim per riorganizimin e Shoqerise,per bashkimin ose perthithjen e saj me Shoqeri te tjera tregtare per ndryshimin e formes filllestare juridike te saj, si dhe per prishjen e Shoqerise dhe kalimin e saj ne likuidim.

5.Vendos percaktimin e rregullave per procedurat e mbajtjes dhe pjesmarrjes ne Asamble dhe per miratimin e RREGULLLORES se brendeshme, ne parim dhe nen per nen.

Vendimet e mesiperme te Asamblese jane te vlefshme,vetem atehere kur ato miratohen me **shumice te KUALIFIKUAR,me ¾ e votave te aksionereve** te pranishem apo me perfaqesim ne mbledhjen e saj,ne te kunderten ato jane akte juridike administrative,absolutisht te pavlefshme.

Te gjitha Vendimet e Asamblese duhet te rregjistrohen ne nje rregjister te vecante te vendimeve dhe ne menyre kronologjike,te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen dhe ne menyre imperative(domosdoshmerisht) duhen rregjistruar keto vendime te Asamblese:

1.Vendimi per miratimin e pasqyrave vjetore dhe te raporteve ekonomiko financiare te ecurise se veprimtarise se Shoqerise tregtare.

2.Vendimi ne lidhje me shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve.

3.Vendimi per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.

4.Vendimet ne lidhje me kryerjen e investimeve, ato per marrjen e kredive bankare,per blerje te pasurive te paluajtshme si dhe te paisjeve dhe teknologji ne vlera,mbi 2000.000 lek qe i sherbejne ecurise dhe persosjes se infrastruktures te aktivitetit te Shoqerise.

5.Vendimet per riorganizimin e Shoqerise,sikurse jane kalimi ne nje forme tjeter juridike te organizimit te saj,bashkimit ose perthithjes me shoqeri te tjera vendase apo te huaja si dhe vendimet qe merren per PRISHJEN e shoqerise dhe kalimin e saj ne likuidim.

6.Çdo vendim tjeter qe parashikohet ne ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 ,dhe qe nuk kerkon marrjen e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme me votim te cilesuar,me ¾ e votave me te drejte vendimore.

Ne raste se keto vendime jane te PARREGJISTRUARA ne rregjistrin e vendimeve ato jane akte absolutisht te pavlefshme dhe Shoqeria nuk mund t'i kunderdrejtoj pavlefshmerin te tretit qe ka fituar nga shoqeria te drejta ne mirebesim.pervec rastit kur Shoqeria provon se i trej ka pasur dijeni per pavlefshmerin apo ne baze te rrethana te qarta nuk mund te mos kishte patur dijeni per te.

Neni 12

Eksperti kontabel:

Me propozim te keshillit te Administrimit dhe me vendim te Asamebles Se aksionerve te shoqerise Caktohet Nje ose me shume Ekspert Kontabel, qe mund te jete perosn Fizik ose Juridik. Mandati si expert kontabel eshte 3 vjet me te drejt rizgjedhje. Si ekspert kontabel shoqeria emerom Z. Dorianin Agalliu , antare i IEK me numer licence 126. Emerimi dhe largimi i ekspertit kontabel behet me vendim te Assamblese se oksionerve te shoqerise.

Neni 13

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME



Asambleja e pergjithshme mbledhet ne rastet e percaktuara ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 apo ligje te tjera dhe STATUT dhe si rregull mbledhja e pergjithshme e Asamblese se zakonshtme thirret te pakten nje here ne vit,por nuk perjashtohet qe kjo mbledhje te behet sa here eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise.

Te drejten e thirrjes se Mbledhjes se Asamblese pergjithshme e kane anetaret e Keshillit ADMINISTRIMIT, Administratori i Shoqerise dhe aksioneret qe zoterojne aksione qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise te cilet ja drejtojne kerkesen me shkrim,perfshire dhe komunikimin me poste elektronike ADMINISTRATORIT te Shoqerise,jo me vone se 8 dite para mbledhjes se Asamblese dhe ne rast se kerkesa nuk pranohet keta ortake,qe zoterojne 5% te kapitalit kane te drejte qe me vetinisiative te therresin Asamblen e pergjithshme dhe te vendosin per rendin e dites ,duke respektuar kerkesat e parashikuara nga neni 137 i Ligjit per menyren e thirrjes se Asamblese Pergjithshme.

Neni 14

PERFAQESIMI,PJESMARRJA ,PROCESVERBALET E MBLEDHJEVE TE ASAMBLESE ,KUORUMI ,MARRJA E VENDIMEVE,MENYRE VOTIMIT,E DREJTA VOTES DHE PERJASHTIMI NGA VOTA.

a.Perfaqesimi ne Asamble:

Nje Aksioner mund te perfaqesohet ne Asamblen e Pergjithshme ne baze te nje autorizimi me shkrim ose me Prokure nga nje aksioner tjetër apo nga nje person i trete,i cili eshte i vlefshem vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin dhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite

ADMINISTRATORI dhe anetaret e Keshillit ADMINISTRIMIT nuk mund te veprojne si perfaqesues te aksionereve ne Asamblen e Pergjithshme, as me autorizim dhe as me Prokure te bere me akt noterial.

b. Njoftimi dhe Pjesemarrja ne Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme:

Njoftimi per daten,ore,rendin e dites dhe vendin e zhvillimit te Mbledhjes se Asamblese pergjithshme i behet ço aksioneri, nepermjet mjeteve te komunikimit masiv,sikurse jane ato nepermjet shpalljes ne nje Gazete te shtypit te perditeshem, njoftimit ne nje nga televizionet ne shkalle kombetare,njoftimit me me shkrese me ane te postes rekomande ose postes elektronike,njoftim qe çdo aksioner duhet ta marr jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese

Per zhvillimin dhe drejtimin e Mbledhjes zgjidhet me votim me shumice Kryetari i mbledhjes se Asamblese ,dhe nje person caktohet per mbajtjen e procesverbalit te zhvillimit te mbledhjes,ne te cilin pasqyrohet data,ora dhe vendi i zhvillimit te mbledhjes,Rendi i Dites,diskutimet,propozimet dhe pyetje pergjigjet e bera gjate mbledhjes.

Njoftimi per daten,ore,rendin e dites dhe vendin e zhvillimit te Mbledhjes se Asamblese pergjithshme i behet ço aksioneri, nepermjet mjeteve te komunikimit masiv,sikurse jane ato nepermjet shpalljes ne nje Gazete te shtypit te perditeshem, njoftimit ne nje nga televizionet ne shkalle kombetare,njoftimit me me shkrese me ane te postes rekomande ose postes elektronike,njoftim qe çdo aksioner duhet ta marr jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e Asamblese..

Gjate mbledhjes se Asamblese se pergjithshme,pergatitet me shkrim dhe lista e aksionereve te pranishem dhe te perfaqesuesve te tyre,ku shenohen emrat dhe adresat e sejcilit,dokumenti i identifikimit si shtetas (Pasaporte biometrike ose Karte Identiteti) sebashku me numurin e aksioneve,numurin e votave qe japin keto aksionet,vleren nominale te aksioneve si dhe llojin apo kategorin e tyre te zoteruara nga secili pjesmarres dhe kjo liste e plotesuar me shkrim sipas ketyre kerkesave,iu vihet ne dispozicion aksionereve dhe perfaqesuesve te tyre dhe nenshkruhet prej tyre,duke vene emrin,mbiemrin dhe nenshkrimin origjinal.

lista emerore e aksionereve pjesmarres apo qe jane me perfaqesim dhe numuri i kuotave te kapitalit dhe te votave qe zoterohet nga ana e tij

c.Kuorumi,marrja e vendimeve,menyra e votimit, e drejta e votes,perjashtimi nga votimi.

*** KUORUMI:**

Asambleja e Pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te aksionereve qe marrin pjese ne votim,sipas parashikimeve te nenit 145 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 dhe konkretisht kur:

- 1.Vendos per ndryshimet ne STATUT.
- 2.Vendos per shperndarjen e fitimeve vjetore.
- 3.Vendos per zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit te rregjistruar.

4.Merr vendim per riorganizimin e Shoqerise,per bashkimin ose perthithjen e saj me Shoqeri te tjera tregtare per ndryshimin e formes filllestare juridike te saj, si dhe per prishjen e Shoqerise dhe kalimin e saj ne likudim.

5.Vendos percaktimin e rregullave per procedurat e mbajtjes dhe pjesmarrjes ne Asamble dhe per miratimin e RREGULLORES se brendeshme, ne parim dhe nen per nen.

Ne rastin e ceshtjeve qe vendosen me shumice te zakonshme,Asambleja pergjithshme ka te drejte dhe merr vendime te vlefshme ,vetem ne se jane te pranishem ose te perfaqesuar aksioneret qe zoterojne me shume se 30% te aksioneve me te drejte vote vendimore .

Asambleja pergjithshme me shumice te zakonshme dhe kur votojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar qe zoterojne me shume se 5 % te aksioneve me te drejte vote vendimore ,vendos te nis dhe nje hetim te posaçem per parregullsitet ne veprimet e themelimit te shoqerise dhe te ushtrimit te veprimtarise tregtare duke kerkuar qe hetimi te kryhet nga nje ekspert i pavarur i fushes.

Asambleja e Pergjithshme ka te drejte ti kerkoj Gjykates se juridiksionit perkates SHFUQIZIMIN e vendimeve te Keshillit Administrimit apo ADMINISTRATORIT kur konstaton dhe vlereson shkelje te renda te ligjit dhe Statutit, duke respektuar te gjitha modalitetet qe parashikohen nga neni 151 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 duke marr vendimin perkates dhe per rastet kur aksionaret qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave te Asamblese ose kreditoret e shoqerise pretendojne se Shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5% te kapitalit te rregjistruar.

Per vendimin e paditur ne Gjykate Shoqeria mund te marr pjese ne gjykim ,duke u perfaqesuar nga ADMINISTRATORI i Shoqerise ose nepermjet nje perfaqesuesi te paisur me Prokure te Posaçme,te caktuar mbi bazen e vendimit me shkrim te Asamblese

*** Menyra e Votimit:**

Asambleja e pergjithshme merr vendime,si rregull dhe pergjithsesisht me votim te hapur por ne rast se nje nga aksioneret qe zoteron mbi 5% te aksioneve me te drejte vote vendimore propozon qe votimi te behet i fshehte,perparesi Asambleja i jepet votimit te fshehte me kuti

Ndersa per emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit ADMINISTRIMIT apo Administratorit te Shoqerise,Asambleja e Pergjithshme vendos me votim te fshehte kur kjo menyre votimi kerkohet nga aksionaret te cilet zoterojne nje numur aksionesh qe perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te rregjistruar te Shoqerise.

Ne perputhje me dispozitat e pikes 1 te nenit 122 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 l(nje) aksion mbart te drejten e nje vote me te drejte vendimore.

ç.Perjashtimi nga votimi:

Aksionari nuk mund te ushtroj te drejten e votes,nese Asambleja e Pergjithshme duhet te marr vendim per:

- 1.Vleresimin e veprimtarise se tij.
- 2.Faljen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.
- 3.ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga Shoqeria.
- 4.dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Ky ndalim zbatohet edhe per personin e autorizuar nga aksionari qe e ka caktuar perfaqesues te tij per mbledhjen e Asamblese pergjithshme.

d.Te drejtat e lidhura me aksionin.

Aksionari,qe pengohet te ushtroj te drejtat,te cilat rrjedhin nga zoterimi i aksionit te shoqerise ka te drejte ti kerkoj Gjykates se juridiksionit perkates qe te urdheroj ndalimin e cenimit apo te kerkoj demshperblim.

PADIA duhet te ngrihet prej tij **brenda 3 vjeteve** pas pengimit te ushtrimit te se drejtes.

N e n i 15

KESHILLI ADMINISTRIMIT.

Keshilli Administrimit, eshte organ kolegjal, i perbere nga **3 veta**, te emeruar nga Asambleja e Pergjithshme, i cili si organ kqyr dhe merr vendim per menyren e venies ne zbatim te politikave tregtare te shoqerise ne perputhje me ligjin dhe statutin dhe Vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe **drejtohet nga KRYETARI, i zgjedhur me shumice te zakonshme votash nga anetaret e tij ose i propozuar nga Asambleja e Pergjithshme.**

Funksionet Keshillit te Administrimit, si organ kolegjal, kryesisht jane ato te percaktuara ne nenin 154 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 dhe ka keto te drejta, detyrime dhe pergjegjesi :

- 1.Te jap direktiva per administratoret per zbatimin e politikave tregtare te Shoqerise.
- 2.Te kontrolloj e te mbikqyr zbatimin e politikave tregtare te shoqerise nga administratoret.
- 3.Te pergatise ,me kerkese te Asamblese ,marrjen e masave,qe jane ne kompetence te kesaj te fundit,t'i rekomandoj Asamblese vendimet e nevojshme qe duhen marre si dhe te zbatoj me korektese Vendimet e Asamblese.
- 4.Te therrase me vetinisative, Mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme,sa here qe vleresohet se ajo eshte e domosdoshme dhe e nevojshme per interesat e veprimtarise tregtare te Shoqerise.
- 5.Te kujdeset ne vijemsi qe Shoqeria te respektoj ligjin dhe standartet e kontabilitetit.
- 6.Te shqyrtoj dhe te kontrolloj rregullisht si vete dhe me specialist te fushes se kontabilitetit, librat kontabel,cdo praktike dokumentare dhe aktivet e Shoqerise.
- 7.Te siguroj pasqyrat financiare vjetore,raportet e ecurise se veprimtarise si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit,te detyrueshme ne baze te ligjit dhe Statutin qe ato te kryhen me korektese dhe sakesi nga Administratoret dhe personeli menaxhues i Shoqerise.

Te kerkoj qe keto dokumenta te miratohen dhe nenshkruhen nga te gjithe anetaret e Keshillit Administrimit dhe ti paraqiten Asamblese se pergjithshme ,te shoqeruar dhe me nje RAPORT analitik me shkrim me qellim per miratimin e tyre nga Asambleja e Pergjithshme dhe per ti prezantuar Asamblese nje pershkrim te shkruar per mbikqyrjen e menaxhimit gjate gjithë vitit financiar.

8.Keshilli i Administrimit,ka dhe te drejten te emeroj dhe shkarkoj ADMINISTRATORIN ,te percaktoj kompetencat e tij si dhe pagen e shperblimit te tij, duke marr me pare pelqimin me shkrim nga Asambleja e Pergjithshme.

9.Te miratoj me shumice votash, vendimet per marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5% te asetëve te Shoqerise,qe rezultojne si detyrime ne pasqyrat e fundit financiar te certifikuara nepermjet nenshkrimet te huave apo emetimit te obligacioneve apo instrumentave te tjera te borxhit,dhe te autorizoj Drejtorin Administrimit per ekzekutimin ne kohe dhe me korektese te ketyre vendimeve .

10. Te vendos me shkrim per te orientuar dhe propozuar politikat per krijimin e bashkepunimeve tregtare afatgjata ,per bashkimin me shoqeri tregtare te tjera,vendase apo te huaj,celjen e filialeve apo degeve te tjera te Shoqerise brenda vendit apo jashte shtetit dhe keto vendime vihen ne zbatim pasi te jene miratuar dhe nga Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise, te propozoj prishjen apo perthithjen e shoqerise,te ndryshoj formen ligjore si dhe cdo veprim ne perputhje me ligjin dhe Statutin ,me kusht qe mos te cenoj kompetencat vendimore te Organit me te larte drejtues te Shoqerise qe eshte Asambleja e Pergjithshme..

11.Keshilli i Administrimit me shumice te thjeshte votash,mund ti kerkoj Gjykates perkatese shkarkimin e nje anetari te tij,ne se ai ka shkelur detyrat e parashikuara ne **piken 3 te nenit 163 te ketij ligji** dhe konkretisht, anetari i Keshillit Administrimit ka vepruar ne kundershtrim me detyrat dhe shkelin standartet e kujdesit dhe qe kane sjell si pasoje cenimin e padrjete te interesave te ligjshme te Shoqerise,duke kerkuar qe ata te shperblejne ne menyre te plote demin e shkaktuar,si pasoje e veprimeve dhe mosveprimeve ne kundershtrim me permbushjen e rregullt te detyres se tyre.

Anetaret e Keshillit te Administrimit jane te detyruar ti shperblejne Shoqerise demet e shkaktuara nese,ne kundershtrim me dispozitat e Ligjit"Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" kryejne veprimet e meposhtme:

- U kthejne aksionereve kontributet.
- U paguajne aksionareve interesa apo dividente.

- Nenshkruajne ,blejne dhe pranojne si garanci apo anulojne aksionet e Shoqerise.
- Emetojne aksione perpara kalimit te kontributit ne natyre apo shlyerjes se vleres nominale ose me çmim me te larte.
- Shperndajne aktivet e shoqerise.
- Lejojne qe shoqeria te vazhdoj veprimtarine tregtare,kur,ne baze te gjendjes financiare duhej te ishte parashikuar se shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet.
- Kur ne rast te zmadhimit te kapitalit,emetojne aksione perpara permbushjes se kushteve apo kur kontributi nuk eshte kaluar sipas kerkeseve te nenit 123 te ligjit per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare.
- Kryejne pagesa ne favor te anetareve te Keshillit te Administrimit apo Administratorit ose japin kredi. Per shlyerjen e demit civil dhe moral te shkaktuar nga keto veprime arbitrare te nje apo disa anetareve te Keshillit te Administrimit, Shoqeria ka te drejten qe ngrrej Padi civile ne Gjykatën e Juridiksionit perkates,**brenda 3 vjeteve** nga kryerja e shkeljes apo zbulimi i saj.

Anetaret e Keshillit te Administrimit,mbajne pergjegjesi solidare per vertetesen e te gjitha pasqyrave financiare,te publikimeve te detyrueshme dhe informacioneve te tjera kryesore te veprimtarise se organizimit te shoqerise,per informacionet e dhena per sistemimin e menaxhimit te riskut te shoqerise perspektivat e shoqerise,planet e investimeve,burimet teknike,organizative dhe burimet,strukturat e praktikat e miraadministrimit te shoqerise

Anetaret e Keshillit te Administrimit ,kane detyrimin e besnikerise dhe si detyrim kryesor qe :

Te kryejne detyrat e tyre,te percaktuara ne ligj dhe Statut,ne mirbesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi,duke i kushtuar vemnendje te vecante ndikimit te veprimtarise se saj ne Mjedis dhe Publik.

Te ushtrojne kompetencat qe u njeh kigji dhe Statuti vetem per arritjen e qellimeve te ligjshme te veprimtarise se shoqerise,te parandalojne dhe te menjanojne rastet e konfliktit,te pranishme apo te mundeshme,te interesave personale me ato te shoqerise,,te garantojne ecurin e marrveshjeve te miratuara.

Keshilli i Administrimit merr vendim me shkrim per pranimin ose refuzimin e kerkeses per kryerjen e Mbikqyrjes se vecante per ceshtje te posaçme,sidomos kur kerkohet shqyrtimi i ligjshmeris se veprimeve te Administratoreve

N e n i 16

Shoqeria Aksionere **"ADI GAZ 2020 "** Sh.A. çel Llogari BANKARE ne lek vendi dhe ne çdo lloj valute te huaj,ne Banka Vendase ose te huaja private ose shtetore,me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

N e n i 17

ZMADHIMI I KAPITALIT

Kapitali i rregjistruar i Shoqerise mund te zmadhohet duke emetuar aksione rishtazi kundrejt kontributeve te reja qe japin aksionaret.

Aksionaret e shoqerise kane te drejten e PARABLERJES per aksionet e emetuara rishtazi apo te aksioneve ekzistues ne rast se nuk ka shtim te kapitalit fillestar te rregjistruar,dhe e ushtrojne kete te drejte ne perpjestim me pjesen e kontributit te kapitalit te rregjistruar qe perfaqesojne aksionet e

zoteruara prej tyre dhe kjo e drejte duhet te ushtrohet jo me vone se 20 dite pas publikimit te parashikuar ne nenin 169 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008. ,publikim qe **ADMINISTRATORI i Shoqerise** duhet ta njoftoj per rregjistrim ne QKR ,vendim i cili duhet te PUBLIKOHET dhe ne faqen e internetit te Shoqerise.

Ne rast se nje aksionar nuk deshiron te ushtroj te drejten e parablerjes, me kalimin e afatit kohor limit prej 30 ditesh nga publikimi i vendimit per shitjen e aksioneve te kapitalit te rregjistruar aksioneri tjetër ka te drejten e tjetersimit te ketyre aksioneve,mbi bazen e aktit noterial personave fizik apo juridik vendas apo te huaj, **me kusht qe ai mos te kete detyrime ndaj shoqerise ne momentin e shitjes tyre tek te tretet.**

Aplikimi per rregjistrimin e zmadhimit te Kapitalit prane QKR duhet te shoqerohet dhe me dorezimin e raportit te ekspertit te autorizuar,me qellim qe te verifikohet vlere e kontributeve te cdo aksionari.

Perpara se zmadhimi i kapitalit te rregjistrohet prane QKR,aksionet e reja nuk mund te emetohen dhe te drejtat e lidhura me to nuk mund te transferohen apo tjettersohen .

Zmadhimi i kapitalit te Shoqerise miratohet **me ¾ e votave** ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme,me pjesmarrje apo perfaqesim te aksionareve qe zoterojne kapitalin sipas kontributit respektiv dhe gezojne disponimin e votave me te drejte vendimore.

Ne rastet e zmadhimit te kapitalit,rregjistrimi i vendimit te mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te shoqerohet me BILANC te veprimtarise ekonomiko financiar dhe me raport me shkrim te ekspertit kontabel te autorizuar,ne te cilin parashtrohen te argumentuar vlera e aktiveve te shoqerise qe mundesojne nje zmadhim te tille.

Aplikimi dhe dergimi i dokumentave te mesiperme prane QKR duhet te shoqerohet dhe me nje DEKLARATE me shkrim te ADMINISTRATORIT te Shoqerise me anen e te ciles ai verteton dhe konfirmon se gjendja e aktiveve te Shoqerise eshte e tille qe,nese vendimi per zmadhim do te ishte marre ne ditene aplikimit per rregjistrim prane QKR,zmadhimi do te ishte ende i mundur per tu kryer.

Njoftimi per rregjistrim ne QKR duhet te percaktoj se zmadhimi i kapitalit eshte kryer me kalimin e rezervave te shoqerise ose me fitimin e pashperndare.

N e n i 18

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali fillestar i rregjistruar i Shoqerise ,mund te ZVOGELOHET me vendim i cili **miratohet me ¾ e votave** ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme,me pjesmarrje apo perfaqesim te aksionareve qe zoterojne kapitalin sipas kontributit respektiv dhe gezojne disponimin e votave me te drejte vendimore .

Zvogelimi i kapitalit te rregjistruar realizohet nepermjet zvogelimit te vleres nominale te aksioneve.

Kapitali i rregjistruar mund te zvogelohet nen vlerat minimale te parashikuara nga neni 107 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008,vetem me kusht kur zvogelimi shoqerohet me nje Zmadhim te njekohshem te kapitalit.

Vendimi per zvogelimin e Kapitalit i njoftohet QKR per rregjistrim nga ana e **ADMINISTRATORIT** ne perputhje me nenin 43 te ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit dhe menjiher pas aplikimit per depozitimin dhe rregjistrimin e ketij vendimi ne QKR, ai duhet te PUBLIKOHET dhe ne faqen e internetit te Shoqerise.

KAPITALI konsiderohet i zvogeluar nga data qe-eshte bere rregjistrimi i vendimit ne QKR.

Aktiviteti Ekonomiko financiar i Shoqerise AKSIONERE ,ndahet ne periudha te cilat zgjasin 12 Muaj ,kohe e cila si rregull fillon nga data 01 Janar deri me daten 31 Dhjetor te cdo viti Kalendarik,me perjashtim te periudhes se pare e cila fillon daten e rregjistrimit te Shoqerise ne QKR dhe **perfundon me daten 31.12.2013.**

N e n i 19

Shoqeria te mbaj nje KONTABILITET te rregullt per administrimin e Pasurise dhe gjithe veprimtarine ekonomiko financiare te saj,ne pajtim me kerkesat e Ligjit Nr. 10091 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te rregjistruar dhe te kontabilistit te miratuar"

N e n i 20

Shoqeria Aksionere " **ADI GAZ 2020**" Sh.A.,sikurse parashikon neni 187 i Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 mbaron si Person JURIDIK dhe priset ne keto raste :

- 1.Kur mbaron kohezgjatja ,per te cilen eshte themeluar .
- 2.Me VENDIM te Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve e saj,sipas kushteve ligjore te ushtrimit te kesaj te drejte vendimore..
- 3.Me hapjen e procedurave te FALIMENTIMIT.
- 4.Ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet radhazi dhe nuk eshte njoftuar PEZULLIMI i veprimtarise ne perputhje me kerkesat e nenit 43 pika 3 e Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR"
- 5.Me vendim Gjykate.
- 6.Per arsye te tjera te parashikuara ne Statutin e Shoqerise.

Prishja e Shoqerise behet vetem nbi bazen e Vendimit me shkrim te Asamblese se Aksionerve te miratuar me $\frac{3}{4}$ e votave te aksionereve te shoqerise ,qe jane zoterues te kapitalit te regjistruar dhe zoterojne aksione me te drejte vote vendimore.

Zoterimi i te gjitha aksioneve ,ne formen e lejuar nga ligji,ne nje dore te vetme nuk konsiderohet dhe as sjell si pasoje prishjen e shoqerise.

N e n i 21

Me prishjen e saj Shoqeria kalon ne LIKUIDIM.

Vendimi i Likuidimit te Shoqerise,i marre mbi bazen e Mbledhjes se Asamblese se Aksionereve te Shoqerise apo ne LIGJ, u behet i njohur te gjithë AKSIONEREVE,zoterues te aksioneve te Shoqerise nepermjet PUBLIKIMIT te ketij VENDIMI me mjetet e INFORMIMIT PUBLIK dhe duke respektuar te gjitha procedurat ligjor duke caktuar nje Likudator.

Emerimi i LIKUIDATORIT behet mbi bazen e vendimit me shkrim te Asamblese se Pergjithshme dhe ne se asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim per emerimin e likuidusve ,brenda 30 diteve nga data e shpalljes se PRISHJES se Shoqerise,çdo person i interesuar mund t'i drejtohet Gjykates per te kerkuar caktimin e likuidusit te Shoqerise.

Çdo person i interesuar,ne rast se krijon bindjen se Likudatori i caktuar me vendim te Asamblese se Pergjithshme,nuk eshte i pershtatshem per te bere likudimin e shoqerise,ai ka te drejte qe ti drejtohet Gjykates me KERKESE per te caktuar nje likudus tjetër,brenda 30 diteve nga data e caktimit ter likuiduesit nga ana e Asamblese se Pergjithshme.

Te ARDHURAT e arketuara nga LIKUIDIMI i Shoqerise,pas shlyerjes se çdo detyrimi ndahen ne mes Aksionereve sipas vleres se Kontributit te sejcilit prej tyre ne formimin e Kapitalit Themeltar.

N e n i 22

ADMINISTRATORI i Shoqerise,i njofton per rregjistrim QKR te dhenat e Likuidusve sebashku me dokumentat perkatese ,sipas kerkesave te nenit 43 te Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" dhe likuiduesi apo likuiduesit e emeruar depozitojne ne QKR specimentet e nenshkrimt te tyre dhe likuiduesit kane detyrimin per te njoftuar QKR per cdo ndryshim te identitetit dhe te tagrave te tyre te perfaqesimit.

Ne rastet kur likuiduesi emerohet me vendim Gjykate ai rregjistrohet ne QKR "ex officio" sipas percaktimit qe parashikon neni 45 i Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR"

Me hapjen e procedurave te likuidimit,emri i regjistruar i Shoqerise aksionare shoqerohet me **shenimin " Shoqeri ne LIKUIDIM"**

N e n i 23

ADMINISTRIMI,TE DREJTAT e DETYRIMET E LIKUDUESIT

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorve nga data e emerimit te tij

Likuiduesi u nenshtrohet **MBIKQYRJES** Asamblese se Pergjithshme dhe Keshillit te Administrimit te Shoqerise edhe ne rastin kur ai eshte emeruar nga Gjykata.

Likuiduesi duhet te njoftoj menjehere kreditoret e Shoqerise per te depozituar pretendimet e tyre per prishjen e Shoqerise.

Shoqeria nepermjet ADMINISTRATORIT e publikon dy here njoftimin per kreditoret me nje interval kohe prej 30 ditesh ne faqen e saj ne Internet dhe ne rast se nuk ka internet ne faqen e internetit te QKR.

Detyra e Likuiduesit eshte MBYLLJA e te gjitha veprimeve te Shoqerise,mbledhja e kredive te paarketuar dhe e kontributeve, te pashlyera,shitja e pasurive te shoqerise(pasuri te luajteshme dhe te paluajteshme) dhe shlyerjen e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit sipas nenit 605 te Kodit Civil

Likuiduesi mund te kryej edhe veprime te reja tregtare,per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.

Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret,sipas nenit 194 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 ,likuiduesi apo likuiduesit vrejne se pasuria e shoqerise tregtare,perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per

pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit DETYROHEN te pezullojne proceduren e likidimit dhe ti paraqesin Gjykates se Juridiksionit perkates nisjen e procedurave te FALIMENTIMIT.

Likuiduesi mbi bazen e nje raporti me shkrim ,pasqyron shlyerjen e detyrimeve te shoqerise ndaj kreditoreve dhe shperblimit te likuiduesit sebashku me rimbursimin e shpenzimeve te tij ne kryerjen e detyrave dhe aktivet e mbetura u shpermdahen aksionareve sipas perkatesise se kontributit ne formimin e kapitalit themeltar.

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, Likuiduesi njofton QKR per perfundimin e likudimit dhe kerkon ÇRREGJISTRIMIN e Shoqerise ne perputhje me Seksionin V te Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR"

Veprimtaria e likuiduesit nuk mund te kundershtohet pas çrregjistrimit te Shoqerise nga QKR.

N e n i 24

Çdo mosmarrveshje, ne ushtrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise si rregull duhet te zgjidhet ne mirekuptim ne te kunderten ajo mund te behet objekt i Konfliktit Civil para Gjykates se rrethit Gjyqesor Durres.

N e n i 25

Ky STATUT miratohet unanimitisht, ne parim dhe nen per nen, me 100% te votave "Pro" nga Aksioneri I VETEM Themelues **Z. Adrian Mujali** dhe autorizohet Administratori i Shoqerise **Z. Adrian Mujali** qe te beje aplikimet e nevojshme per rregjistrimin e ketij Statuti dhe te Kontrates se Themelimit prane Qendres Kombetare te rregjistrimit.

N e n i 26

Ky STATUT i krijimit te Shoqerise Aksionere "**ADI GAZ 2020** " Sh.a . Durres-Albania u redaktua ne 5 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike dhe nenshkruhet pa vajtje nga aksioneret themelues duke vene emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

AKSIONARI I VETEM THEMELUES

ne Mbledhjen e PARE te Asamblese se Aksionerve te
SHOQERISE AKSIONERE "**ADI GAZ 2020**" Sh.A. Durres-Albania

MIRATUES te ketij S T A T U T I

Shtetasi Shqipetar
Z. ADRIAN MUJALI

Adrian Mujali
